



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:906995

Datë: 12.01.2021

Numri i dokumentit: 01401517

A.C.nr.1139/2018

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit : Bujar Muzaqi – Kryetar, Nehat Idrizi, dhe Burim Shala, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit E.B. nga fshati "...", Komuna Fushë Kosovë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, me seli në Rr. "Luan Haradinaj", Komuna Prishtinë, të cilën e përfaqëson N.A., përfaqësuese ligjore nga Avokatura Shtetërore, në çështjen kontestimore për anulimin e vendimit, kthim të gradës, dhe kompensim i të ardhurave personale, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile, C.nr.1468/13 datë 31.05.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.01.2021, mori këtë :

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, me seli në Rr. "Luan Haradinaj", Komuna Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për çështje civile, C.nr.1468/13 datë 31.05.2017, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1468/13 datë 31.05.2017, ndër të tjera ka vendosur si vijon : "... I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit E.B.. II. Anulohen si të kundërligjshme vendimet e të paditurës: Nr.07/1-01A 3051, datë 22.05.2013, Nr. 07/1-01A/3052, datë 22.05.2012, Nr. 195/KBD/2013 dt. 10.904.2013 dhe Nr. 67-KA-2013, datë 15.05.2013. III. Detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në pozitën me gradë rreshter në Policinë e Kosovës dhe për periudhën kohore 16.02.2012 deri më 17.10.2016 (si datë e hartimit të ekspertizës financiare) t'i paguaj dallimin në pagë midis pozitës së zyrtarit policor dhe rreshterit në shumën e parave prej 4231.92€, në emër të pagës neto, shumën prej 486.65€ në emër të kontributit pensional dhe shumën prej 391.33€ në emër të tatimit në burim në pagë. IV. Detyrohet e paditura që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën e parave prej 120€..."

Kundër aktgjykimit C.nr.1468/13 datë 31.05.2017, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, për shkak të : Shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimin e goditur me këtë ankesë ta ndryshoj ose të njëjtin ta kthejë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se :

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi E.B. nga fshati "...", Komuna Fushë Kosovë, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, me seli në Komuna Prishtinë.

Në petitumin e padisë të paditësit ndër të tjera thuhet se *"... Të APROVOJ në tërësi ankesën time të bazuar duke ma kthyer gradën e Rreshterit, anulimin e transferit administrativ duke ma kthye në vendin e punës..."*.

Paditësi me parashtresën e datës 29.09.2016, e ka precizuar padinë, dhe ndër të tjera ka kërkuar nga Gjykata që të shfuqizoj *"... Aktvendimin me numër 07/1-01A/3051 të datës 22.05.2013, i cili ka të bëjë me urdhëresë për ekzekutimin e vendimit Degradimit nga grada Rreshter në gradën Zyrtar policor. Aktvendimin me numër 07/01-01A/3052 të datës 22.05.2013 i cili ka të bëjë me urdhëresë për ekzekutimin e vendimit Transfer Administrativ, nga Departamenti i Policisë Kufitare – Njësia e Hetimeve me seli në Prishtinë në Drejtorin Rajonale të Veriut të Policisë Kufitare në Lluzhan. Duke përfshi edhe vendimin m e numër 67-KA-2013 të datës 15.05.2013 i cili ka qenë i potencuar edhe në padi..."*.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës kryesore dëgjimit të palëve në procedurë dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.1468/13 datë 31.05.2017, me të cilin aktgjykim e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, Gjykata e shkallës së parë ndër të tjera e ka arsyetuar se: *"... kërkesëpadija e paditësit për anulimin e vendimit për shqiptimin e masës disiplinore – degradimi në pozitë – transfer administrativ, është e bazuar, pasi nga provat e administruara ka rezultuar se aktvendimi i KBD, i vërtetuar edhe nga KPASH, është marrë si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike që ka rezultuar me zbatimin e gabuar të drejtës materiale...sipas vlerësimit të gjykatës paditësit i është shqiptuar masa disiplinore transfer në detyrë dhe degradim në pozitë në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 par.7 dhe nenit 7 të Udhëzimit administrativ nr.15/2008 të MPB, nenit 46 pika a dhe c të Ligjit për Policinë e Kosovës (03/L-035) dhe nenit 85 par 1 pika 3 të Ligjit për punë..."*.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të palës së paditur se kemi të bëjmë me shkelje të procedurës, dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i kjohtë dhe i përmbarueshëm, dhe rrjedhimisht i njëjti është në harmoni edhe me arsyet e aktgjykimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë nuk është kontestuese se paditësi ka qenë në pozitën e rreshterit të e paditura.

E paditura me vendimin nr.195KBD/13, i ka shqiptuar paditësit masën disiplinore degradim, dhe transfer administrativ, njëherit ndaj paditësit është filluar edhe procedurë penale në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me datë 16.01.2013, ka paraqitë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, Aktvendim për pushim të hetimeve ndaj paditësit E.B., për veprën penale zbulim i fshehtësisë zyrtare, në këtë aktvendim ndër të tjera thuhet se *“...Prokuroria vjen në përfundim se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të ngritur aktakuzë kundër të pandehurit E.B....”*.

Prokuroria Themelore në Prishtinë me datë 08.02.2013, ka lëshuar vërtetim ku në këtë vërtetim ndër të tjera thuhet se *“...Meqëse Prokurori Nerkombtar i ka pushuar hetimet, në Prokurorin Themelore në Prishtinë konsiderohet rast i shqyrtuar dhe i mbyllur...”*.

Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte se me vendimin nr.195KBD/13 e të paditures, ku me këtë vendim i është shqiptuar paditësit masa disiplinore – degradim, dhe transfer administrativ, ku sipas këtij vendimi paditësi kishte zbuluar fshehtësi zyrtare, dhe se ky vendim i të paditurës për degradimin e paditësit nga grada rreshter a është i bazuar në Udhëzimin administrativ 06/2012, në bazë të cilit udhëzim është degraduar paditësi, dhe në Ligjin e Policisë së Kosovës.

Në vendimin nr.195KBD/13 të marrë nga e paditura ndër të tjera thuhet se *“...Komisioni i Brendshëm Disiplinor bazuar në Udhëzimin Administrativ 06/2012, neni 58, pika 3, punonjësit të akuzuar i shqipton masën disiplinore : Degradim... Komisioni i Brendshëm Disiplinor konform Udhëzimit Administrativ 06/2012, neni 45, pika 2, i shqipton masën plotësuese: Transfer Administrativ...”*.

Gjykata gjatë shqyrtimit të vendimit 195KBD/13, Aktvendimin me numër 07/1-01A/3051 të datës 22.05.2013, i cili ka të bëjë me urdhëresë për ekzekutimin e

vendimit Degradimit nga grada Rreshter në gradën Zyrtar policor, Aktvendimin me numër 07/01-01A/3052 të datës 22.05.2013 i cili ka të bëjë me urdhëresë për ekzekutimin e vendimit Transfer Administrativ, nga Departamenti i Policisë Kufitare – Njësia e Hetimeve me seli në Prishtinë në Drejtorin Rajonale të Veriut të Policisë Kufitare në Lluzhan, në të gjitha këto vendime të marra nga e paditura, është konstatuar se në udhëzimin administrativ 06/2012, nuk është i përfshirë degradimi si masë disiplinore, po ashtu edhe në Ligjin e Policisë së Kosovës nuk është i përfshirë si masë disiplinore degradimi.

Gjykata vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka llogaritur shumën e aprovuar për paditësin dhe e ka detyruar të paditurën t'ia kompensoj paditësit për ndryshimin e pagave të papaguara për periudhën kontestuese dhe atë t'i paguaj dallimin në pagë midis pozitës së zyrtarit policor dhe rreshterit në shumën e parave prej 4231.92 €, në emër të pagës neto, shumën prej 486.65 € në emër të kontributit pensional, shumën prej 391.33 €, në emër të tatimit në pagë, këtë llogaritje e ka bërë duke u bazuar në mendimin e ekspertit gjyqësor F.M., i cili ekspert është dëgjuar në seancën e gjyqësore të mbajtur në Gjykatë me datë 18.01.2017, dhe i autorizuari i të paditurës pas deklarimit të ekspertit, ndër të tjera ka deklaruar se “... *nuk ka pyetje për ekspertin ...*”, si dhe nuk ka pasur vërejtje në provat e administruara nga Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur në Gjykatë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara

Sa i përket vendosjes nga gjykata e shkallës së parë lidhur me shpenzimet e procedurës, nuk ka pasur pretendime ankimore.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.1139/2018 datë 12.01.2021

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Bujar Muzaqi